



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 140/ 5 prot.

Datë 21.02.2024

V E N D I M
Nr. 206/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 21.02.2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “KLAME” SHPK nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-93015-01.11.2024, me objekt: “*Blerje orendi dhe pajisje për mobilim zyresh për Spitalin Universitar Obstetrik-Gjinekologjik, ‘Mbretëresha Geraldinë’*”, me fond limit 41,171,800.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 12.02.2024, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara.

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-93015-01-11-2024, me objekt: “*Blerje orendi dhe pajisje për mobilim zyresh për Spitalin Universitar Obstetrik-Gjinekologjik, ‘Mbretëresha Geraldinë’*”, me fond limit 41,171,800.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 12.02.2024, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara.

Ankimues:

Operatori ekonomik “KLAME” SHPK me NIPT K21518003F dhe adresë: Rruga “Gani Kryeziu” Nr.23, kati i dytë, Njësia Administrative 11, Kodër Kamëz, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara.
Adresa: Blv. "Dëshmorët e Kombit", Nd. 1, 1001, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik". Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19".

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:**I***Vlerësimi Paraparak*

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 12.01.2024, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit "E hapur, mbi kufirin e lartë monetar", me Nr. REF-93015-01-11-2024 me objekt: "Blerje orendi dhe pajisje për mobilim zyrash për Spitalin Universitar Obstetrik-Gjinekologjik, 'Mbretëresha Geraldinë', me fond limit 41,171,800.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar më datë 12.02.2024, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara.

II.2. Në datën 22.01.2024, në formë shkresore, pranë Komisionit të Prokurimit Publik është administruar ankesa e operatorit ekonomik “KLAME” SHPK, si edhe pranë autoritetit kontraktor, është administruar ankesa në datën 22.01.2024, referuar kjo informacionit të autoritetit kontraktor me Nr. 97/4, datë 29.01.2024, protokolluar me tonën 140/2, datë 31.01.2024, ku operatori ekonomik ka kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Njëpërmjet shkresës nr. 97/4 prot., datë 29.01.2024, protokolluar me tonën me nr. 140/2 prot., datë 31.01.2024, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, vendimi i autoritetit kontraktor, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “KLAME” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5. Referuar shkresës së sipërcituar të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “KLAME” SHPK dhe e ka njoftuar atë se ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës si më poshtë:

[...] Referuar kodit CPV të fjalorit të Prokurimeve Publike miratuar me VKM nr. 457 date 30.07.2021 "Per miratimin e fjalorit të prokurimit publik", KSHA shqyrtoi dhe krahasoi të gjithë artikujt e përmendur në ankimin e OE nga ku rezultoi:

Artikujt që pretendohen pajisje mjeksore:

-Lavaman inoksi me dy gropa (pretendohet se është lavaman për autopsi)

-Lavaman inoksi me dy gropa me distance (pretendohet se është lavaman për balsamim) - Karroce për shërbime emergjente (me pajisje për shërbim reanimacioni nga doreza latexe deri debriofilator)

- Karroce e levizshme (për transport materiale mjeksore)

- Karroce me rrota për pajisje sterile - Dollap me plumb për lende radioaktive

- Karroce inkosi me gropa

Ne lidhje me keto zera, KSHA pasi ju referua pershkrimit teknik në DST, konstatoi se disa zera si Karroce për shërbime emergjente (me pajisje për shërbim reanimacioni nga doreza latexe deri debriofilator), Karroce e levizshme (për transport materiale mjeksore), Dollap me plumb për lende radioaktive, Karroce me rrota për pajisje sterile dhe Dollap me plumb për lende radioaktive, kanë qartësisht një funksion mjeksor dhe ato mund të klasifikohen si "Pajisje mjekësore, farmaceutike dhe produkte të kujdesit personal" Per kete arsye kjo pjese e ankeses është e drejte, pasi këto zera të objektit të prokurimit nuk kanë lidhje me pajisje mobilimi për zyra dhe ambiente të tjera. Ne keto rrethana operatori ekonomik mund të ketë vështiresi për të furnizuar ato nëse nuk është i angazhuar në tregtine e pajisjeve mjeksore. Në konkluzion të këtij shqyrtimi, vlerësojme, se Njesia e prokurimit duhet të rishikojë procedurën e prokurimit për "Spitalin Geraldine" dhe ndarjen me lote të objektit të prokurimit, respektivisht me dy lote sipas natyres, pershkrimit dhe funksionit të tyre:

1. Pajisje mjeksore dhe

2. Blerje orendi dhe pajisje për mobilim zyrash.

Per sa më sipër, keto pretendime të ankimuesit "Klame" SHPK qëndrojnë. [...]

II.6. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik, konstatohet, se Autoriteti Kontraktor, nuk e ka publikuar shtojcën në sistemin e prokurimit elektronik sipas vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave.

II.7. Pranë Komisionit të Prokurimit Publik, operatori ekonomik ankimues "Klame" SHPK nuk ka paraqitur "Formularin e argumenteve shtesë", pas vendimit të KSHA-së lidhur me ankesën.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit për modifikimin e dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Referuar shkresës së autoritetit kontraktor nr. 97/4 prot., datë 29.01.2024, protokolluar me tonën me nr. 140/2 prot., datë 31.01.2024, rezulton, se ky i fundit ka vendosur pranimin pjesërisht, duke pranuar kërkesën si me poshtë:

[...]Referuar kodit CPV të fjalorit të Prokurimeve Publike miratuar me VKM nr. 457 date 30.07.2021 "Per miratimin e fjalorit të prokurimit publik", KSHA shqyrtoi dhe krahasoi të gjithë artikujt e permendur në ankimin e OE nga ku rezultoi:

Artikujt që pretendohen pajisje mjeksore:

- Lavaman inoksi me dy gropa (pretendohet se është lavaman për autopsi)*
- Lavaman inoksi me dy gropa me distance (pretendohet se është lavaman për balsamim)*
- Karroce për sherbime emergjente (me pajisje për sherbim reanimacioni nga doreza latexe deri debriofilator)*
- Karroce e levizshme (për transport materialesh mjeksore)*
- Karroce me rrota për pajisje sterile - Dollap me plumb për lende radioaktive*
- Karroce inkosi me gropa*

Ne lidhje me keto zera, KSHA pasi ju referua përshkrimin teknik në DST, konstatoi se disa zera si Karroce për sherbime emergjente (me pajisje për sherbim reanimacioni nga doreza latexe deri debriofilator), Karroce e levizshme (për transport materialesh mjeksore), Dollap me plumb për lende radioaktive, Karroce me rrota për pajisje sterile dhe Dollap me plumb për lende radioaktive, kanë qartësisht një funksion mjeksor dhe ato mund të klasifikohen si "Pajisje mjekësore, farmaceutike dhe produkte të kujdesit personal". Per kete arsye kjo pjese e ankeses është e drejte, pasi këto zera të objektit të prokurimit nuk kanë lidhje me pajisje mobilimi për zyra dhe ambiente të tjera. Ne keto rrethana operatori ekonomik mund të ketë vështiresi për t'i furnizuar ato nëse nuk është i angazhuar në tregtine e pajisjeve mjeksore. Ne konkluzion të këtij shqyrtimi, vlerësojmë

se Njesia e prokurimit duhet të rishikojë procedurën e prokurimit për "Spitalin Geraldine" dhe ndarjen me lote të objektit të prokurimit respektivisht me dy lote sipas natyrës, pershkrimit dhe funksionit të tyre:

1. Pajisje mjeksore dhe

2. Blerje orendi dhe pajisje për mobilim zyrash.

Per sa më sipër, keto pretendime të ankimuesit "Klame" SHPK qëndrojnë [...]

III.1.2. Neni 30 i LPP-së, parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.*

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 "Për prokurimin Publik", i cili parashikon shprehimisht se : *"1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

III.1.4. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik konstatohet, se Autoriteti Kontraktor nuk e ka publikuar, në sistemin e prokurimit elektronik, shtojcën me ndryshimet përkatëse sipas vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, për të cilën nga ana e operatorit ekonomik ankimues nuk ka patur ankesë.

Komisioni i sjell në vëmendje autoritetit kontraktor, publikimin e shtojcës.

Për këtë arsye, KPP do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me këtë pjesë të pranuar nga autoriteti kontraktor për ankesën me nr. 140 prot., datë 22.01.2024, të operatorit ekonomik "Klame" SHPK.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "Klame" SHPK, se [...]Sa me sipër, kërkojmë ndarjen në lote të procedurës, duke prokuruar më vete:

• "Mobilje (përfshirë mobiljet e zyrave), pajisje shtëpiake (përfshirë ndriçimin) dhe produkte të pastrimit

më vete:

• "Pajisje mjekësore, farmaceutike dhe produkte të kujdesit personal".

më vete:

• "Makineri kompjuterike dhe zyrash, pajisje dhe furnizime përjashtuar mobiljet dhe paketat software

më vete: "Materiale ndërtimi dhe produkte ndihmese për ndërtimin".[...]

Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në dokumentet e tenderit, "Njoftimi i Kontratës", autoriteti ka parashikuar si vijon:

2.2 Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP) 39112000-0, 39121200-8, 39121100-7.

III.2.2 Në dokumentet e tenderit, Në shtojcën 2 "LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE", autoriteti ka parashikuar si vijon:

Lista e Çmimeve

Nr.	Artikujt	Njësia matuese	Sasia
1.	Kolltuk me hapje (behet shtrat tek)	Cope	5
2.	Stol për dhomat e ndërrimit <i>Min 100x40x45cm Max 110x50x55 cm</i>	Cope	3
3.	Tabele druri për të varur shenimet (e mbyllur) <i>Min 180x7.5 D x120 "H cm Max 190x8.5 D x130 "H cm</i>	Cope	10
4.	Raft librash i hapur <i>Min 90 x 45 x 200 cm Max 100 x 55 x 210 cm</i>	Cope	1
5.	Raft librash I hapur me strukture metalike <i>Min 80x32x180cm Max 90x42x190 cm</i>	Cope	1
6.	Dollap për dhomë pacienti <i>Min 50x50x200 cm Max 60x60x210 cm</i>	Cope	105
7.	Komodine me sirtar dhe kanat për pacientet <i>Min 45x50x75cm; Max 55x60x80cm</i>	Cope	72

8.	Sirtarierë e lëvizshme me rrota <i>Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min 45 x 50 x 60 cm Max 55 x 55 x 65 cm (lartësi së bashku me rrotat).</i>	Cope	5
9.	Dollap medikamentesh me xham <i>Min 90x55x190 cm Max100x60x200 cm</i>	Cope	45
10.	Dollap per barna kundra zjarrit <i>Min 90x50x180cm Max 100x60x190cm</i>	Cope	1
11.	Lavaman inoksi me sirtare	Cope	5
12.	Lavaman te inkastruar brenda mobiljes, mobilja me 2 sirtare <i>Dimensionet: Min 90x60x75cm Max 100x70x85cm</i>	Cope	11
13.	Raft për dosje (etazher) <i>Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min 90 x 45 x 190 cm Max 100 x 50 x 200 cm</i>	Cope	60
14.	Dollap per arkive <i>Min 80 x 45 x 180 cm Max 90 x 55 x 190 cm</i>	Cope	7
15.	Dollap veshje/zhveshje Garderop <i>Min 90x45x190 cm Max 100x50x200 cm</i>	Cope	15
16.	Karroce per sherbim emergjente	Cope	2
17.	Paisje per pastrim	Cope	10
18.	Karroce furnizimi <i>Min 95x55x70 cm Max 105x65x80 cm</i>	Cope	2
19.	Karroce me rrota per paisjet sterile <i>Min 60cm x 60cm x 175cm Max 70cm x 70cm x 185cm</i>	Cope	1
20.	Karrige per ngrenie <i>Min 59x57x44/83cm; Max65x62x49/88cm</i>	Cope	4

21.	Karrige e thjeshte per dhome pacienti <i>Min 45x45x85cm</i> <i>Max 55x55x95cm</i>	Cope	2
22.	Karrige tek me krah mbeshtetes <i>Min 50x60x70cm</i> <i>Max 55x65x75cm</i>	Cope	83
23.	Karrige për rangun drejtues	Cope	2
24.	Karrige jo statike me krahë mbështetës	Cope	53
25.	Poltron rrotullues <i>Min 60 x 40 x 80 cm</i> <i>Max 65 x 45 x 90 cm</i>	Cope	2
26.	Karrige rrotulluese me krah mbeshtetes per laborator	Cope	5
27.	Stol pritje dyshe <i>Min 107x66x78 cm</i> <i>Max 115x70x83 cm</i>	Cope	5
28.	Stol pritje teke <i>Min 50x66x78 cm</i> <i>Max 60x70x83 cm.</i>	Cope	1
29.	Stol pritje treshe <i>Min 178x66x78cm</i> <i>Max 183x70x83cm</i>	Cope	7
30.	Lavaman inoxi me 2 gropa <i>Min 170x60x75cm</i> <i>Max 180x65x80cm</i>	Cope	2
31.	Lavaman inoxi me 2 gropa me distance <i>Min 480x 60x75/100cm</i> <i>Max 530x 65x75/110cm</i>	Cope	5
32.	Mobilje inoxi me lavaman per dhomat e papastra <i>Min 160x60x75 cm</i> <i>Max170x65x80 cm</i>	Cope	1
33.	Rafte per dhomat e pastra <i>Min 180x50x200 cm</i> <i>Max 190x55x210 cm</i>	Cope	5
34.	Paisje mbajttese letre	Cope	32
35.	Paisje per detergjent likuid per larje duarsh	Cope	24

36.	Stol ndihmes <i>Min 40x30x20cm</i> <i>Max 50x40x30cm</i>	Cope	10
37.	Kosh per mbeturina jo magnetik MRI	Cope	1
38.	Receptione 1.Holli rruga kryesore <i>Min 330x80x105cm</i> <i>gjeresi 80 cm</i> ; 2.Holli ambjent I brendshem <i>Min 400x80x105cm</i> <i>gjeresi 50 cm</i> 3.Urgjenca <i>Min 110x50x105cm</i> <i>gjeresi 90 cm</i> 4.Holli i pritjes <i>Min 340x275x105cm</i> <i>gjeresi 90 cm</i>	Cope	7
39.	Poltron statik për tavolinë mbledhje	Cope	2
40.	Mobilje per Kuzhine <i>Min 400x85x75 cm</i> <i>Max 410x90x80 cm</i>	Cope	3
41.	Dollap personeli me celes <i>Min 90x50x72-216 cm</i> <i>Max 100x55x77-220 cm</i>	Cope	4
42.	Dollap metalik me dyer <i>Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min 90 x 40 x 195 cm; Max 100 x 50 x 205 cm</i>	Cope	1
43.	Dollap për dosje dy kanatesh <i>Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): Min 80 x 45 x 180 cm; Max 90 x 50 x 200 cm</i>	Cope	2
44.	Mbajtese per veshje dhe doreza e levizshme <i>Min 70 x 50 x 200 cm; Max 80 x 60 x 210 cm</i>	Cope	1
45.	Mbajtese per veshje dhe doreza fiksuar ne mur <i>Min 148 x 70 x 15cm; Max 153 x 75 x 25 cm</i>	Cope	1
46.	Dollap per ilace me strukture kundra zjarrit <i>Min 90x50x180cm; Max 100x60x200cm</i>	Cope	3

47.	Dollape me plumb per lendet radioaktive <i>Min 70x70x180 cm; Max 90x90x200 cm</i>	Cope	4
48.	Raft inoksi <i>Min 100x50x198cm; Max 110x60x205cm</i>	Cope	76
49.	Poltron pritje njëvendësh (kolltuk njëvendësh) <i>Min 92 x 89 x 84 cm; Max 100 x 95 x 90 cm</i>	Cope	3
50.	Poltron pritje dyvendësh (kolltuk dyvendësh) <i>Min 186 x 95 x 94 cm; Max 190 x 100 x 105 cm</i>	Cope	5
51.	Karroce inoksi me 2 gropa <i>Min 60x60x90cm; Max 70x65x100cm</i>	Cope	4
52.	Stativ <i>Rregullues lartësie jo me pak se 160-220 cm. Diametri i tubit jo me pak se 2.5 cm</i>	Cope	5
53.	Tabele per projektor <i>Min 178x178 cm; Max 190x190 cm</i>	Cope	1
54.	Stol rrotullues me rregullim lartësie <i>rregullimi i lartësisë jo me pak se 560 në 790 mm</i>	Cope	30
55.	Stol per MRI <i>Min 100x60x110cm; Max 130x80x160cm</i>	Cope	1
56.	Tavoline ngrenie <i>Min 130x60x70cm; Max 140x65x80cm</i>	Cope	2
57.	Tavoline pune laborator me lavaman <i>Dimensionet: Gjatesi Nga 240 deri 260 cm Dimensionet: Gjerësi Nga 85 deri 95 cm Dimensionet: Lartësi Nga 75 deri 100 cm</i>	Cope	1

58.	Tavoline per instrumentat <i>Min 76x40x86 cm; Max 80x50x90 cm</i>	Cope	9
59.	Tavolinë zyre mesi <i>Përmasat (gjatësi x gjerësi x lartësi): Min 60 x 60 x 42 cm; Max 65 x 65 x 55 cm.</i>	Cope	1
60.	Tavolinë mesi <i>Përmasat (gjatësi x gjerësi x lartësi): Min 110 x 55 x 45 cm; Max 120 x 65 x 55 cm</i>	Cope	1
61.	Tavolinë mbledhje rang drejtuesi, 12 persona <i>Përmasat e tavolinës të jenë jo më pak se 320 cm x 140 cm x 75 cm</i>	Cope	1
62.	Tavolinë pune + Komodinë <i>Tavolinë pune (gjatësi x gjerësi x lartësi): Min 115 x 70 x 72 cm Max 120 x 75 x 77 cm Komodina: Min 40 x 60 x h-68 cm; Max 50 x 70 x h-75 cm</i>	Cope	57
63.	Tavoline pune per 1 post <i>Min 180x70x75cm; Max 190x75x80cm</i>	Cope	1
64.	Tavoline pune per 2 poste <i>Min 200x70x75cm Max 210x75x80cm</i>	Cope	1
65.	Tavoline pune per 2 poste <i>Min 220x70x75cm Max 230x75x80cm</i>	Cope	1
66.	Tavoline per 2 poste <i>Min 360x70x75cm Max 370x75x80cm</i>	Cope	1
67.	Tavoline pune per 3 poste pune <i>Min 400x70x75cm Max 410x75x80cm</i>	Cope	1

68.	Tavoline pune ne forme L <i>Min 160x80x75cm Max 170x85x80cm</i> <i>Min 75x45x75 cm Max 85x50x80cm</i>	Cope	1
69.	Tavoline pune e thjeshte <i>Min 100x100x75 cm Max 110x110x80 cm</i>	Cope	1
70.	Televizor LCD 32"	Cope	7
71.	Perde me shine <i>Gjatesia Min 200 cm; Max 250 cm, Lartesia</i> <i>Min 200 cm Max 250cm</i>	Cope	15
72.	Perdeme perberje plumbi me shine	m2	440
73.	Tavoline inoksi me 4 rrota <i>Min 90x40x80cm Max 100x50x90cm</i>	Cope	1
74.	Karroce per mbajtese ilacesh <i>Min 78x46x97cm Max 83x51x102cm</i>	Cope	5
75.	Karroce inoksi me 2 gropa dhe sirtare <i>Dimensionet e karroces Min 110x70x90 cm</i> <i>Max 120x75x95 cm</i> <i>Permasat e sirtarit: Min 30 x 65 x 9 cm Max 40 x 70 x 15 cm.</i> <i>Diametri i gropes Min 35 cm; Max 45 cm</i>	Cope	1
76.	Karroce me rrota me 3 sirtar <i>Min 65x55x100cm Max 75x65x110cm</i>	Cope	1
77.	Karroce per persona me aftesi te kufizuar	Cope	5
	Fondi total (Lekë pa tvsh)		41,171,800

III.2.3 . Neni 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikon se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit

publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.2.4 Neni 39 i ligjit nr.162/2020, “Për prokurimin publik” parashikon shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të japë një kontratë në formën e loteve të veçanta, duke përcaktuar madhësinë dhe objektin e këtyre loteve. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

2. Autoriteti ose enti kontraktor përcakton në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi ose kur thirrja për konkurrim bëhet përmes njoftimit për ekzistencën e një sistemi kualifikimi, në ftesën për ofertë ose për të negociuar, nëse ofertat mund të dorëzohen për një, për disa ose për të gjitha lotet. Edhe kur ofertat mund të dorëzohen për disa ose të gjitha lotet, autoriteti ose enti kontraktor mund të kufizojë numrin e loteve që mund t'i jepen një ofertuesi, nëse numri maksimal i loteve për ofertues deklarohet në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi, në ftesën për ofertë ose në ftesën për të negociuar. Kur zbatimi i kriterëve për shpalljen e kontratës fituese do të bënte që një ofertues të shpallej fitues i më shumë loteve sesa numri maksimal, autoriteti ose enti kontraktor përcakton në dokumentet e tenderit kriteret objektive dhe jodiskriminuese ose rregullat që synojnë të zbatohen për të përcaktuar lotet që do të jepen.

3. Kur të njëjtit ofertues mund t'i jepet më shumë se një lot, autoriteti ose enti kontraktor mund të japë kontrata që kombinojnë disa ose të gjitha lotet, pasi të kenë specifikuar në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi mundësinë për ta bërë këtë, dhe lotet ose grupet e loteve që mund të kombinohen.

III.2.5. Neni 42 i VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” parashikon shprehimisht se:

1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.

2. 2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit.

Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale

III.2.6. Referuar kthim - përgjigjes së autoritetit kontraktor mbi argumentimin lidhur me këtë pikë, autoriteti është shprehur në pranim të saj, duke cituar, se “Në konkluzion të këtij shqyrtimi, vlerësojmë, se Njësia e prokurimit duhet të rishikojë procedurën e prokurimit për ‘Spitalin Geraldine’” në ndarjen me lote të objektit të prokurimit, respektivisht me dy lote sipas natyrës, përshkrimit dhe funksionit të tyre:

1. Pajisje mjekësore dhe
2. Blerje orendi dhe pajisje për mobilim zyresh

III.2.7 Nga shqyrtimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, KPP konstaton, se objekti i këtij prokurimi, është blerja nga ana e autoritetit kontraktor e mallrave të tilla si: “Pajisje mobile për mobilim zyresh dhe mjete spitalore”. KPP vëren, se autoriteti kontraktor e ka pranuar, duke cituar se do e ndajë në 2 (dy) lote. Referuar parashtrimeve në ankesë rezulton, se ankimuesi kërkon ndarjen në 4 (katër) lote të procedurës së prokurimit.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se ndarja ose jo, e një kontrate në lote, është një vendim i rëndësishëm që autoriteti kontraktor merr gjatë procesit paraprak të prokurimit, pasi ndikon drejtpërdrejtë në nivelin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi. Kjo bëhet duke mbajtur në konsideratë elemente të tilla si: tregu, konkurrenca e mundshme, vlera e prokurimit, kostot e ekzekutimit të kontratës dhe vështirësia teknike lidhur me ndarjen në lote etj., dhe veçanërisht faktin nëse objekti i kontratës është një punë/shërbim/mall, për të cilin ofertuesit janë të paktë. Gjithashtu, referuar nenit 39 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, autoriteti kontraktor në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Në rastin konkret, autoriteti kontraktor e ka argumentuar vendimin e tij lidhur me këtë pikë, duke pranuar ndarjen në lote të procedurës. Me pranimin e pretendimit nga ana e autoritetit kontraktor për ndarjen në lote, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në rastin konkret, ka përmbushur qëllimin e ligjit, lidhur me nxitjen e konkurrencës dhe stimulimin e pjesëmarrjes së biznesit të vogël. Akoma më tej KPP gjykon, se ankesa e operatorit ekonomik lidhur me ndarjen në lote, përkatësisht në 4 lote, është e paargumentuar, pasi në asnjë moment nga ana e tij, nuk janë përcaktuar mallrat që do duhet të prokurohen për secilin lot të pretenduar. Theksojmë, se operatori ekonomik ankimues “KLAME” SHPK, nuk ka paraqitur argumente shtesë, ku kundërshton vendimmarrjen e KSHA me nr. 97/4 prot, datë 29.01.2024, ku kjo e fundit ka pranuar për ndarjen të procedurës përkatësisht në 2(dy) lote.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “KLAME” SHPK ku kërkon: “Nga sa me siper, kerkojme heqjen e kerkeses qe kontrata te jete noteriale pasi kjo na kursen edhe leke pasi dihet qe kontratat noteriale kushtojne rreth 7.000 leke.”

III.3.1. Në shtojcën 7 të dokumenteve të tenderit, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, kapaciteti teknik, pika 2.3.3, autoriteti kontraktor ka parashikuar”

3.Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë të paktën 2 (dy) mjete transporti, me qëllim transportin e mallrave, të cilët duhet t'i ketë në pronësi ose me qira.

Per sa me siper operatori ekonomik te paraqese nje deklarate perkatese sipas formatit te meposhtem:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Kapaciteti mbajtes	Statusi
1				Pronesi/qira/perdorim

Shenim 3.1:

Per mjetet me status perdorimi qira/hua perdorje te disponohet kontrata noteriale perkatese mes qiradhenesit dhe qiramarresit.

Mjetet e transportit qe do te deklarohet detyrimisht do ti paraqitet Autoritetit Kontraktor per te qene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

III.3.2 Në kthimin e përgjigjes për shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues me nr. 97/4 prot., datë 29.01.2024, protokolluar me tonën nr. 140/2 prot., datë 31.01.2024, për këtë pretendim autoriteti kontraktor në mënyrë të përmbledhur ka argumentuar: [...]Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave vlerëson, se pretendimi i Operatorit Ekonomik nuk qëndron për kete arsye: KSHA vlereson se ky pretendim nuk qëndron. Kerkesa është plotësisht e realizueshme

nga cdo operator ekonomik pjesemarres, pasi kosto e noterizimit te dokumentit është minimale dhe plotesisht proporcionale ne raport me fondin limit për prokurim dhe shpenzimet administrative te një subjekti pjesemarres ne nje prokurim publik. Gjithashtu, vlerësojme se kërkesa për te noterizuar dokumentet e qirasë se automjeteve eshte nje rregull qe aplikohet gjerësisht nga Autoritetet Kontraktore, që ka si qëllim kryesor shmangien e fiktivitetit te dokumentacionit per plotësimin e kapaciteteve teknike dhe që rrit besueshmerine e pjesemarresve ne nje procedure prokurimi.”

III.3.3. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.3.4. Neni 40, pika 3 dhe 5 ç, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

III.3.5. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor harton dokumentet e tenderit, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Për sa i përket pretendimit të ankimuesit “*kërkojmë heqjen e kërkesës që kontrata të jetë noteriale*”, Komisioni i Prokurimit Publik referuar Kodit Civil përkatësisht nenit 801, është e shprehur qartë, se “*Qiraja është kontrata me të cilën njëra palë (qiradhënësi) detyrohet t'i japë palës tjetër (qiramarrësit) një send të caktuar, në gëzim të përkohshëm kundrejt një shpërblimi të caktuar*” dhe në nenin 803 të Kodit Civil është cituar, se “*Kontrata e qirasë, për një kohë më të gjatë se një vit, duhet bërë me shkresë*”. Pra përcaktohet qartë, se kontratat e qirasë për pasuritë e paluajtshme bëhen me akt noterial, ndërsa kontratat e qirasë për pasuri të luajtshme, nuk është detyrim të bëhen me akt noterial.

Gjithashtu, referuar Kodit Civil, përkatësisht nenit 901 mbi huapërdorimin, shprehet qartë në ligj, se nuk është përcaktuar forma e detyrueshme, që kontrata e huapërdorjes duhet të jetë me akt - noterial.

Komisioni i Prokurimit Publik e gjen të tepërt kërkesën e Autoritetit Kontraktor lidhur me kontratën e qirasë/huapërdorjes, me akt noterial për mjetin e transportit, që do të shërbejë për lëvrimin e mallit, duke ngarkuar me barrë të panevojshme operatorin ekonomik, për të lidhur kontratë me akt - noterial. Për autoritetin kontraktor është i rëndësishëm disponimi nga operatori ekonomik, i një mjeti transporti të kërkuar. Provueshmëria lidhur me këtë kapacitet mund të bëhet edhe me një kontratë qiraje/huapërdorje të lidhur mes palëve konform dispozitave të parashikuara në legjislacionin përkatës, duke ofruar garanci dhe siguri për autoritetin kontraktor, për realizimin me sukses të kontratës.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, që autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin 2.3.3, në heqjen e termit “*e noterizuar*” në kontratën e qirasë/huapërdorjes për mjete transporti, me qëllim për të lehtësuar operatorët ekonomikë, për pjesmarrje në procedurën e tenderimit, në kushtet kur forma noteriale e kërkuar, nuk është e detyrueshme referuar parashikimeve ligjore në fuqi.

Kërkesa e operatorit ekonomik qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “*Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “KLAME” SHPK, për procedurën e prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-93015-01-11-2024 me objekt: “*Blerje orendi dhe pajisje për mobilim zyrash për Spitalin Universitar Obstetrik-Gjinekologjik, ‘Mbretëresha Geraldinë’*”, me fond limit 41,171,800.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 12.02.2024, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “KLAME” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “KLAME” SHPK.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri

